



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2025

**PËR MIRATIMIN E NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE TË
REVIZIONUAR (REV.2.1)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e zbatimit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1), të miratuar paraprakisht nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, bazuar në Shtojcën e Rregullores nr. 2023/137 e cila zëvendëson Shtojcën I të Rregullores (KE) nr. 1893/2006.
2. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1), e njohur shkurtimisht “NVE Rev.2.1”, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.
3. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1) zbatohet nga agjencitë statistikore, ministrinë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Kodet statistikore të veprimtarive ekonomike, të përdorura deri para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zëvendësohen me kodet e parashikuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1), brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.
5. Viti 2025 do të shërbejë si periudhë tranzitore për marrjen e masave përgatitore për implementimin e klasifikimeve të reja të miratuara nëpërmjet këtij vendimi.
6. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të asistojë teknikisht sipas kërkesave institucionet e administratës shtetërore për integrimin e kodeve sipas Nomenklaturës pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohen institucionet dhe subjektet e përmendura në pikën 3 për marrjen e masave përgatitore për zbatimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1).
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**